

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010) dhe neneve 11 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 09 nëntor 2012 miratoi si në vijim:

RREGULLORE PËR HAPJEN DHE MBYLLJEN BREnda DHE JASHTË REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË DEGËVE DHE SUBJEKTEVE TË VARURA TË BANKAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për hapjen dhe mbylljen e degëve të bankave brenda Republikës së Kosovës dhe hapjen e degëve bankare ose subjektit të varur jashtë Republikës së Kosovës.
2. Kjo Rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në Nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jo bankare (në vijim: Ligji për bankat) dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - a) *Bankë* - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur ose degë të bankës së huaj;
 - b) *Degë* - do të thotë një vend i aktivitetit biznesor, i cili formon një degë ligjërish të varur të bankës të pa themeluar në vete, nëpërmjet të cilës bankës mund t'i lejohet që të angazhohet në veprimtari bankare;
 - c) *Subjekt i Varur* - do të thotë çdo person juridik në të cilin një person tjetër ose grup personash, që vepron së bashku zotëron drejtpërdrejtë apo tërthorazi (i) pesëdhjetë përqind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote ose (ii) një interes të konsiderueshëm, që ia mundëson këtij personi apo grupi të personave të ushtrojnë një kontroll mbi personin juridik në të cilin zotërohen ato aksione.

Neni 3
Hapja dhe/ose zhvendosja e degëve të bankave brenda
Republikës së Kosovës

1. Banka që vendos të themelojë ose të zhvendosë një zyrë të degës duhet të dorëzojë një aplikacion në BQK dhe të marrë aprovimin paraprak. Gjithashtu kërkohet një përshkrim i aktiviteteve të planifikuara të degës, sipas nevojës nga BQK-ja mund të kërkohen edhe informata të tjera plotësuese.

2. Zhvendosja e degës, varësisht nga afërsia e lokacionit të ri me lokacionin e mëparshëm dhe që nuk ndikon në mënyrë thelbësore në natyrën e biznesit ose shërbimet ndaj klientëve, duhet apo mund të mos ketë nevojë për aprovim nga BQK-ja, kështu që në këto raste, bankat duhet të njoftojnë BQK-në në lidhje me zhvendosjen për të përcaktuar nëse aprovimi është i nevojshëm. Banka gjithashtu është e obliguar të njoftojë paraprakisht klientët për zhvendosje të njësisë dhe lokacionin e ri. Makinat për tërheqje të parave (ATM) dhe degët mobile nuk konsiderohen si degë sipas kësaj rregulloreje.

3. Vendimi i BQK-së për të aprovuar apo refuzuar aplikacionin për degë ose zhvendosjen e degës bazohet si në vijim:

- a) Ndikimi i hapjes apo zhvendosjes në komunitetin në të cilin dega është apo do të lokalizohet;
- b) Rezultatet e ekzaminimit të BQK-së mbi mundësitë e degës. Banka duhet të demonstrojë për ta bindur BQK-në se dega është e gatshme, nga aspekti operativ, t'i shërbejë publikut me kushtet e sistemit të tij kompjuterik, me staf dhe me sigurim. Banka duhet të ketë sisteme të shëndosha për menaxhimin e rrezikut duke përfshirë edhe politikat dhe procedurat me shkrim për veprimtarinë e degës.
- c) Gjendja financiare e bankës. BQK-ja merr parasysh përmbajtjen dhe kapacitetin e bankës, duke përfshirë madhësinë dhe kushtet financiare të bankës, si dhe duke përfshirë profitabilitetin dhe mjaftueshmërinë e kapitalit. Gjithashtu, BQK-ja do të marrë parasysh çdo masë detyruese ndaj bankës, qoftë ekzistuese ose të së kaluarës, në vendimin për të aprovuar ose refuzuar aplikacionin për degë.

4. Miratimi do të jepet vetëm pas kompletimit dhe analizimit të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) marrëveshja/kontrata me kompanitë e sigurimit të licencuara nga BQK-ja, që kryejnë aktivitet në Republikën e Kosovës, për sigurimin e ndërtesës dhe të pajisjeve;
- b) marrëveshja/kontrata për mbrojtjen e ndërtesës dhe të pajisjeve me kompanitë që ofrojnë shërbim të mbrojtjes dhe sigurisë fizike të licencuara nga organi kompetent në Republikën e Kosovës;
- c) marrëveshja/kontrata e qirasë në bazë të së cilës subjekti ka të drejtë të përdorë ambientet ku dega do të kryej veprimtari bankare;
- d) adresa e saktë e degës së re; dhe

- e) njoftimi me shkrim për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë në përputhje me aktet ligjore dhe nënljgore në fuqi, për kryerjen e veprimtarisë bankare;

5. Aplikacionet dhe udhëzimet për themelimin ose zhvendosjen e një dege merren në BQK. Për themelimin e një dege duhet të paguhet tarifa e përcaktuar e licencimit (Skema e tarifave të BQK-së gjendet në webfaqen zyrtare të BQK: www.bqk-kos.org).

6. Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë të degës, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë atë.

7. BQK-ja kryen ekzaminimin para hapjes në lidhje me plotësimin e kushteve të përcaktuara në këtë Rregullorë. Pas kryerjes së ekzaminimit para hapjes, BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së degës, nëse ajo konstaton se kushtet teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e veprimtarisë bankare nuk janë përmbushur.

Neni 4 **Mbyllja e degëve të bankave**

1. Banka duhet t'i dërgojë BQK-së dhe klientëve një njoftim paraprak prej 60 ditësh për mbylljen e degës, kurdo që të propozojë mbylljen e degës në të cilën janë pranuar deponimet, janë bërë pagesat apo huazuar paratë.

2. Njoftimi për mbyllje të degës kërkohet të përfshijë si më poshtë:

- a) Identifikimin e degës që do të mbyllet;
- b) Datën e propozuar të mbylljes;
- c) Raportin e detajuar me arsyet e marrjes së vendimit për mbylljen e degës; dhe
- d) Informatat statistikore apo të tjera që mbështesin mbylljen e degës.

3. Çdo bankë që propozon mbylljen e një dege kërkohet që të bëjë njoftimin për mbylljen e degës si vijon:

- a) Njoftimi me shkrim kërkohet që t'iu dërgohet klientëve të degës për propozimin e mbylljes së degës së paku 30 ditë para datës së propozuar të mbylljes;
- b) Banka duhet të shpallë njoftimin për klientët e degës në mënyrë të dukshme në lokalet e degës së paku 30 ditë para datës së propozuar të mbylljes. Në njoftim duhet të theksohet data e propozuar e mbylljes dhe të identifikohet, se ku mund të shërbehen klientët pas datës së mbylljes ose të sigurohen numra telefonikë për klientët, që të mund të kontaktojnë dhe të përcaktojnë vendet e tilla alternative; dhe
- c) Njoftimi për propozimin e mbylljes së degës kërkohet që të publikohet në media lokale së paku 30 ditë para mbylljes së saj.

4. Bankat obligohen që të asistojnë klientët që janë ndikuar nga mbyllja e degës, në gjetjen e shërbimeve alternative bankare pas datës së mbylljes. Nëse llogaritë e klientëve të degës së mbyllur transferohen në ndonjë degë tjetër të bankës, klientët nuk duhet të ngarkohen me taksë për transfer. Kur klientët pajtohen, llogaritë e klientëve të degës së mbyllur transferohen në bankën tjetër banka duhet të ju ofrojë asistencë klientëve në zhvendosjen e llogarive, duke përfshirë edhe mbulimin e mundshëm të shpenzimeve për hapjen e llogarive në bankën që ka pranuar llogaritë.

5. BQK-ja pranon se zgjerimi apo zvogëlimi i rrjetit të degëve është vendim biznesi i vetë bankës. Mirëpo BQK-ja mund të pengojë përkohësisht bankën deri në 30 ditë kalendarike, në mbylljen e degës, nëse sipas gjykimit të BQK-së mbyllja e degës do të ketë një ndikim të madh negativ në qasjen në shërbime bankare në komunitetin e shërbyer nga ajo degë. BQK-ja do të bazojë vendimet e saj mbi mbylljen e degës në informatat e ofruara sipas kësaj Rregulloreje dhe në komentet publike të pranuar në lidhje me mbylljen e degës.

Neni 5

Hapja e degës, ose e subjektit të varur të bankës jashtë Republikës së Kosovës

1. Në mënyrë që të hapin një degë jashtë Republikës së Kosovës, bankat duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimin e organit vendimmarrës të bankës për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Kosovës;
- b) vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga dega e propozuar;
- c) një kopje të rregullave dhe proceduarve të degës së propozuar, ku të përcaktohen aktivitetet që do të kryhen;
- d) biznes-planin për degën për tri (3) vitet e para të aktivitetit;
- e) shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;
- f) informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;
- g) parashikimin e bankës, të rezultatit financiar të saj pas realizimit të këtij zgjerimi, si dhe ndikimin e tij në gjendjen financiare të bankës;
- h) strukturën organizative të degës së bashku me numrin e punonjësve të propozuar;
- i) emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e bankës;

j) informata për skemën e sigurimit të depozitave në vendin ku do të hapet dega; dhe

k) informata të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga BQK-ja.

2. Për të hapur një subjekt të varur jashtë Republikës së Kosovës, banka duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacioni që kërkohet me nën paragrafët a), b), c) dhe e) të paragrafit 1 të këtij Neni;

b) biznes-plani i subjektit të varur dhe parashikimi për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të bankës, për tre vitet e para të aktivitetit;

c) informacion për dy administratorët kryesorë të subjektit të varur;

d) informacion për identitetin, vendqëndrimin/rezidencën ose selinë si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në subjektin e varur;

e) aktivitetet bankare që subjekti i varur parashikon të kryejë;

3. BQK-ja jep miratimin paraprak për zgjerimin e bankës jashtë Republikës së Kosovës vetëm pasi të jetë bindur pas shqyrtimit të dokumentacionit të pranuar në pajtueshmëri me paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni.

4. Degët e bankave që hapen jashtë territorit të Republikës së Kosovës do të kryejnë vetëm ato aktivitete të përcaktuara në aneksin e licencës së dhënë për bankën amë;

5. Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit të kompletuar për degë ose vartës, BQK-ja duhet të aprovojë ose të refuzojë kërkesën.

Neni 6

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe suspendimeve në pajtim me Nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për banka.

Neni 7

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregulla XXV e BQK-së për themelimin, zhvendosjen, mbylljen e filialeve e miratuar më 17 dhjetor 2003 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni8
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me datë 03 dhjetor 2012.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Gazmend Luboteni